



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.6.2024, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Konstituimi i komisionit.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Eduard Shalsi, Milva Ekonomi, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Evis Kushi, Toni Gogu dhe Erion Braçe.

**Mungojnë:**

Jorida Tabaku, Dhurata Çupi, Flutura Açka dhe Sorina Koti.

**Të ftuar:**

Elisa Spiropali – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëmëngjesi!

Kuorumi i nevojshëm për të hapur mbledhjen është i pranishëm, kështu që, në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, e deklaroj të hapur këtë mbledhje të parë për konstituimin e komisionit.

Së pari, ky është një detyrim që rrjedh nga rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, nga vendimet nr. 50 dhe 53 të Kuvendit, nga Kushtetuta, nga neni 77 i saj, nga Rregullorja, nga neni 24 dhe nga nenet vijuese të saj, akte këto, të cilat kanë themeluar dhe mbështesin funksionimin e këtij komisioni, që ka si qëllim të tij thellimin e reformave shtetformuese për mirëqeverisjen e vendit, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit, gjë që është përcaktuar qartë në rezolutën e miratuar nga Kuvendi.

Vendimi i Kuvendit për ngritjen e këtij komisioni të posaçëm parlamentar ka përcaktuar qartë objektin, fushëveprimin, instrumentet dhe mekanizmat e këtij komisioni. Përgjegjësia jonë është e qartë: të adresojmë disa sfida të rëndësishme në interes të qytetarëve dhe në funksion të procesit të integritetit të vendit, me synimin për ta pasur Shqipërinë në vitin 2030 anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Europian. Ky do të jetë, personalisht, edhe në emër të kolegëve, dua ta shpreh këtë, dhe kam bindjen se do të jetë një proces gjithëpërfshirës në rrafshin politik, institucional dhe social. Në këtë kontekst, roli i opozitës është tejet i rëndësishëm, pjesëmarrja e saj në këtë proces është me rëndësi për qëllimet që do të adresojë kjo reformë.

Jam i keqardhur nga fakti që opozita nuk i është përgjigjur pozitivisht kësaj ftese për bashkëpunim, këtij detyrimi të përbashkët si për ne, si për ta për pjesëmarrje dhe angazhim në këtë komision, që buron nga Kushtetuta, nga rezoluta, nga Rregullorja dhe vendimet e këtij Kuvendi, pjesë e të cilit jemi bashkërisht, sepse ky komision do të synojë të adresojë çështje me rëndësi jetike për qytetarët, për të ardhmen e vendit, çështje që shkojnë përtej interesit të partive tona, pasi i shërbejmë forcimit dhe modernizimit të shtetit, të ardhmes së vendit tonë.

Për fat të keq, edhe për shkak të përvojës së gjatë në Kuvend, situata e sotme më sjell në kujtesë një situatë të ngjashme, kur filloi veprimtarinë në vitin 2014 Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Opozita edhe atëherë, në vitin 2014, megjithëse e kishte votuar ngritjen e atij Komisioni, nuk mori pjesë në mbledhjen e parë për konstituimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi dhe në disa mbledhje në vazhdim. Reflektuan me vonesë, dhe u përfshinë më pas në komision. Koha tregoi që kolegët tanë të opozitës gabuan

atëherë dhe kjo u kushtoi shumë politikisht dhe elektoralisht. Shpresoj shumë që kjo histori të mos përsëritet dhe shumë shpejt ta kemi opozitën midis nesh.

Gjithsesi, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga aktet e Kuvendit dhe në interes të qytetarëve dhe të integritetit, procesi duhet të ecë para, duke zhvilluar një proces sa më gjithëpërfshirës, transparent dhe profesional me përfshirjen dhe kontributin e të gjithë faktorëve dhe aktorëve të mundshëm të shoqërisë civile, të botës akademike, të organizative të biznesit, të aktorëve të ndryshëm të grupeve të interesit, ashtu siç vepruam edhe me reformën në drejtësi, përvojën e së cilës ne do të mundohemi ta përdorim sa më mirë edhe për këtë reformë.

Kjo mbledhje është hapi i parë i natyrës formale, përgatitore, si mbledhje detyruese edhe për ne. Unë besoj fort që, kur ne të marrim vendimet e para, të ecim me hapat e parë, t'u japim përgjigjen e duhur të gjithë atyre që kanë spekuluar deri më tani me apo pa qëllim, me dashje apo pa dashje, lidhur me qëllimin e këtij komisioni, por deri atëherë duhet të punojmë fort, shumë fort dhe të shohim para.

Jam vlerësues dhe e çmoj faktin që në këtë mbledhje të parë konstituimi është e pranishme edhe zonja Kryetare e Kuvendit. E falënderoj zonjën Kryetare për prezencën sot, veçanërisht për impenjimin personal të saj dhe të bashkëpunëtorëve në këtë proces që nga momenti i parë, që me hartimin dhe me miratimin e rezolutës dhe të akteve të tjera të Kuvendit, si dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për fillimin normal të punës së komisionit.

Më lejoni që t'ia kaloj fjalën zonjës Nikolla.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Xhafaj!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Sot po konstituojmë komisionin e posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”. Me vendimin nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë u miratua ngritja e komisionit të posaçëm parlamentar dhe me vendimin nr. 53/2024 u miratua përbërja e këtij Komisioni.

Në këtë mbledhje konstituive dëshiroj që si Kryetare e Kuvendit t'ju uroj punë të mbarë dhe suksese në përmbushjen e misionit që Kuvendi ju ka ngarkuar! Cilësova fjalën “mision”, sepse puna dhe kontributi juaj shkojnë përtej përmbajtjes së zakonshme të objektivave dhe qëllimeve të një komisioni parlamentar, faktikisht, ky komision ka një mision të rëndësishëm kombëtar. Ky mision është i lidhur me përgjegjësitë që Kuvendi i ka ngarkuar për të kontribuar në kurorëzimin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin

European, nëpërmjet ngritjes në një cilësi më të lartë të mirëqeverisjes së vendit, sundimit të ligjit dhe luftës ndaj korrupsionit. Jam këtu për t'ju garantuar se komisioni do të ketë mbështetjen e plotë të Kuvendit dhe timen personale, si Kryetare e Kuvendit. Jo rastësisht nënvizova dimensionin kombëtar të këtij misioni dhe veprimtarisë së komisionit, si një strukturë e posaçme që drejton një proces parlamentar; komisioni nuk ka asnjë ngarkesë politike dhe asnjë interes partikularist apo partiak. Ndaj, në këtë drejtim, duke qenë se ky është një komision gjithëpërfshirës, do të doja të shprehja edhe unë keqardhjen që kolegët e opozitës nuk janë sot prezentë, por jam e bindur që do të marrin përgjegjësitë e tyre përpara qytetarëve, votuesve dhe Shqipërisë edhe si anëtarë të këtij komisioni.

Jam e bindur që ju, anëtarë të komisionit, me kontributin e rëndësishëm, përvojën dhe profesionalizmin e kryetarit të komisionit, zotit Xhafaj, të cilin dua ta falënderoj, do të kontribuoni maksimalisht që ky komision të mundësojë, përmes analizave dhe afirmimit të arritjeve të deritanishme të reformave të ndërmarra, të rekomandojë avancimin dhe thellimin e mëtejshëm të tyre. Është detyra jonë që ta lexojmë me kujdes përvojën e deritanishme të zbatimit të reformave dhe t'u propozojmë Kuvendit dhe qytetarëve shqiptarë ndryshime ligjore dhe institucionale, në mënyrë që të gjithë sektorët e qeverisjes të ecin përpara me ritmet që kërkon koha, Shqipëria euroatlantike, qytetarët dhe partnerët tanë strategjikë.

Demokracia mund të ndërtohet vetëm si një demokraci nën ligj dhe duke respektuar pavarësinë e degëve të saj: legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Zhvillimi i reformave ka nevojë për impulse të reja, ritme më të shpejta dhe proces gjithëpërfshirës, ndaj unë besoj se ky komision dhe të gjithë ju, anëtarë të nderuar të këtij komisioni, jeni këtu për të mundësuar këto ritme dhe këto impulse të reja në zhvillimin e vendit drejt rrugës së anëtarësimit në Bashkimin European, Shqipëria 2030.

Edhe një herë, ju uroj punë të mbarë dhe suksese! Jam besimplotë dhe shpresëplotë që ky komision do të arrijë të gjithë objektivat dhe qëllimet që i ka venë vendit!

Punë të mbarë dhe suksese!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Kryetare, për mbështetjen dhe për mesazhet tuaja në këtë mbledhje të parë të komisionit dhe të jeni besimplotë se ky komision do ta justifikojë më së miri përgjegjësinë që i ka dhënë Kuvendi në përmbushje të misionit të tij!

Në këtë mbledhje të parë është e pranishme edhe zonja Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Kontributi i saj në gjithë këtë proces, që në nisje të tij, ka qenë e mbetet një kontribut i rëndësishëm për veprimtarinë e komisionit dhe të të gjithë procesit gjithëpërfshirës, ekspertëve, grupeve të interesit, shoqërisë civile e të tjerë. Në përmbushje të rolit dhe të misionit të saj në ekzekutiv, prania, kontributi dhe marrëdhënia me

të do të jetë shumë e rëndësishme për lidhjen dhe koordinimin ndërmjet dy pushteteve, pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, i cili në këtë proces, pa dyshim është i përfshirë për shkak të objektit të punës së këtij komisioni, që është objekt për fusha të caktuara, është edhe subjekt i rëndësishëm dhe kontribuues në gjithë këtë mision të rëndësishëm, që është përtej Kuvendit. Ky është një mision në interes të gjithë shoqërisë dhe, natyrisht, ekzekutivi ka një rol përcaktues në këtë aspekt dhe unë shpresoj që marrëdhënia ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit, përmes angazhimit dhe kontributit të zonjës Spiropali, do të jetë shumë efikas, si më parë.

Gjithsesi, më lejoni që t'ia kaloj fjalën zonjës Spiropali.

**Elisa Spiropali** – Shumë faleminderit, zoti kryetar dhe uroj ta justifikoj të gjithë besimin tuaj!

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë dhe anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”,

Procesi i negociatave, me qëllim anëtarësimin e plotë në Bashkimin Europian do t'i japë hov më tej demokratizimit dhe forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxitë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përfaqsimin me nivelet më të mira europiane të mirëqenies dhe të përfshirjes sociale. Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe të detyrimeve që lindin nga MSA-ja. Një nga sfidat kryesore lidhet me domosdoshmërinë për vazhdimin e mëtejshëm dhe thellimin në zbatimin e reformave themelore, duke përfshirë reformën në drejtësi, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike.

Qeveria Shqiptare ka udhëhequr një proces kompleks shqyrtimi analitik në Bruksel. Në përfundim të procesit *screening* janë zhvilluar 67 takime *screening* dhe dypalëshe në Bruksel për 33 kapituj dhe 3 kriteret e anëtarësimit. Janë përfshirë 157 institucione shtetërore dhe 32 institucione të pavarura qeveritare dhe joqeveritare dhe institucione të krijuara me ligj. 575 zyrtarë kanë marrë pjesë në takimet shpjeguese dhe 1 004 zyrtarë në takimet bilaterale. Janë përgatitur 777 prezantime të relatuara dhe të argumentuara me rreth 20 mijë faqe dokumente. Janë zhvilluar 126 ushtrime simuluese, ku janë trajnuar 661 zyrtarë të shtetit.

Shqipëria synon hapjen e negociatave për grupin e parë “Themeloret” brenda 6 muajve të parë të vitit 2024. Procesi *screening* ka pasur rezultat të plotë. Në lidhje me hapjen

e negociatave për grupin e parë “Themeloret”, institucionet shqiptare kanë punuar paraprakisht për hartimin e dy udhërrëfyesve. Aktualisht janë hartuar, janë konsoliduar dhe janë konsultuar me shërbimet e Komisionit Europian udhërrëfyesi “shteti i së drejtës” dhe udhërrëfyesi “reforma në administratën publike”, që përmenden edhe në rezolutën e votuar nga Kuvendi dhe në vendimin e komisionit të posaçëm të Kuvendit. Paralelisht me punën për hartimin e piketave hapëse, është hartuar edhe drafti i parë i pozicionit negociues për “Themeloret”.

Të gjitha këto masa, si më sipër, janë marrë për të siguruar që Shqipëria të jetë gati teknikisht për hapjen e negociatave për Konferencën e Dytë Ndërqeveritare. Në këtë kontekst, rezoluta “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” dhe vendimi për ngritjen e komisionit posaçëm me këtë emër dhe me këtë mision, votuar në Kuvendin e Shqipërisë, vijnë si një manifestim i përgjegjësisë dhe besimit tonë se në këtë fazë vendimtare për modernizimin e shtetit tonë duhet një qasje kombëtare dhe gjithëpërfshirëse. Adresimi i të gjitha rekomandimeve të raporteve të Bashkimit Europian dhe të procesit *screening* kërkojnë një analizë, reagim, koordinim dhe veprim të përbashkët institucional.

Qeveria Shqiptare i ka miratuar të dy udhërrëfyesit e rëndësishëm, por jo vetëm, edhe po i zbaton në përditshmëri si udhëheqëse e këtij procesi anëtarësimi për të përmbushur detyrimet e procesit të negociatave dhe për të bërë të mundur që Konferenca e Parë Ndërqeveritare të zhvillohet sa më shpejt dhe pa vonesë.

Në Bashkimin Europian nuk integrohet qeveria, por shteti shqiptar, ndaj hapësira gjithëpërfshirëse, që i mundësohet Kuvendit nga Kushtetuta dhe kuadri ligjor në fuqi, duhet përdorur si një tregues i vullnetit politik dhe institucional të Shqipërisë, pa dallime partiake, për një cikël të ri reformimi në funksion të mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit, si domosdoshmëri për mbërritjen e objektivit strategjik kombëtar të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian brenda vitit 2030.

Dora jonë për deputetët e opozitës, kolegët tanë, mbetet e shtrirë. Debatet politike janë të përditshme dhe mbahen mend përkohësisht. Dialogu konstruktiv, politik dhe institucional brenda Kuvendit me pushtetet e tjera, si dhe me aktorët e tjerë shoqërorë në vend përbën një qasje të re dhe aq të nevojshme për një cikël të ri reformimi, demokratizimi dhe forcimi të rolit të Kuvendit. Kjo është puna që mbetet.

Qeveria Shqiptare, ministritë dhe institucionet në varësi janë dhe do të mbeten në dispozicion të këtij komisioni për materiale, analiza, të dhëna, ekspertizë, paraqitje, dëgjesa dhe gjithçka mund të lipset në punën tuaj të nderuar.

Punë të mbarë komisionit!

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Ministre! Shpresoj që të kemi një bashkëpunim shumë të mirë në vijim, çka është e domosdoshme për suksesin e punës së këtij komisioni.

A ka nga kolegët diçka tjetër, apo ta përmbyllim këtë fazë të parë?

Atëherë, e konsiderojmë si fillimin e punës. Mbarësi dhe suksese!

Në cilësinë e kryetarit unë kam pasur mundësinë që të merrem me fazën përgatitore të procesit dhe kam punuar edhe me stafin e Kuvendit. Do t'ju propozoja disa vendimmarrje për hapat në vazhdim, që janë kryesisht të natyrës përgatitore, të natyrës organizative, për ta përgatitur procesin për hapat e rëndësishëm më pas, që janë analiza, strategjia, plani i veprimit e të tjera, pra sipas përcaktimeve që ka bërë vendimi i Kuvendit. E kemi të domosdoshme për t'i ndërmarrë këta hapa të parë organizativë, sepse edhe koha nuk është shumë në favorin tonë, për shkak të periudhës, muajit në të cilin jemi dhe kohës së ngjeshur që kemi në dispozicion, që jemi mandatuar nga Kuvendi. Konkretisht, vendimmarrja e parë ose hapi i parë, bazuar në nenin 24 dhe nenet e vijuese të Rregullores së Kuvendit, në pikën 7, paragrafin 2, të vendimit nr. 50 të Kuvendit për krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”, me qëllim për të siguruar një efikasitet sa më të mirë të veprimitarisë së komisionit, në përmbushje të misionit të tij, duke mbajtur në konsideratë edhe kohën në dispozicion për ushtrimin e mandatit të komisionit, anëtarët e tij dhe grupi i ekspertëve, posaçërisht siç është parashtruar në vendimin e Kuvendit, do të organizohen në tri nëngrupe që do të angazhohen për tri fushat kryesore të veprimitarisë së këtij komisioni. Ekspertët do të angazhohen në nëngrupe në funksion të temave përkatëse, që lidhen me fushat e tyre të veprimitarisë në procesin e kryerjes së analizës dhe hartimin e planit kombëtar të veprimit, si dhe propozimin e masave përkatëse legjislative dhe institucionale. Nëngrupet kryesore janë: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit. Natyrisht, kryesia e komisionit do të marrë përgjegjësinë për ta koordinuar dhe për ta organizuar këtë proces me anëtarët e komisionit dhe grupet e ekspertëve në vazhdim, në përputhje me qëllimin e përfshirjes, përvojën dhe kontributet e tyre. Është e nevojshëm kjo vendimmarrje, sepse do t'u bëhet e ditur edhe institucioneve që do të sjellin ekspertë, rrjedhimisht, përveç çka buron nga vendimmarrja e vendimit të Kuvendit, ato duhet të dinë edhe mënyrën se si do të organizohen dhe ku do të përfshihen.

A jemi dakord për këtë gjë? Dakord.

E dyta, mbështetur në të njëjtën bazë normuese të Rregullores së Kuvendit, por tashmë në pikën 8, në paragrafin 1, të vendimit nr. 50 të Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e këtij komisioni, ne e kemi detyrueshme për t'i hapur rrugë procesit, që të marrim vendimmarrjen për t'iu drejtuar me një ftesë për bashkëpunim organizatave të shoqërisë civile, organizatave të biznesit, botës akademike, universiteteve publike dhe jopublike, Akademisë së Shkencave dhe grupeve të interesit për të shprehur interesin e tyre për përfshirje në nivel ekspertësh dhe si pjesë të sekretariatit teknik në tryezat e debatit publik që do të organizohen, si dhe për të kontribuar me të dhëna të ndryshme, analiza, strategji, plane veprimi e të tjera për fusha që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij komisioni.

A jemi dakord për këtë gjë? Dakord.

E treta, lidhet me nevojën, mbështetur në pikën 8, paragrafi 1, të vendimit nr. 50 të Kuvendit, për ngritjen e këtij komisioni, së pari, t'iu drejtohem institucioneve të pavarura që krijohen nga Kuvendi, duke filluar nga Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioni i Prokurimit Publik, Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Instituti i Statistikave, që të propozojnë emrat e përfaqësuesve dhe ekspertëve, me të cilët do të përfaqësohen për të bashkëpunuar dhe për të kontribuar me ekspertizën e tyre në grupet e punës pranë komisionit të posaçëm parlamentar.

Gjithashtu, t'iu drejtohet agjencive ekzekutive ligjzbatuese, po i theksoj këto për të mos pasur ndonjë keqkuptim me institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive, që përfshihen, ndër të tjera, për shpejtësi po bëj një përmbledhje të shkurtër: Agjencia e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Inspektimit Financiar dhe Publik në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Policia e Shtetit për Krimin Ekonomik, për Pastrimin e Parave, njësitë e saj përfaqësuese, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Inspektorati Qendror, Drejtoria e Auditimit, që është në Këshillin e Ministrave, Agjencia e Prokurimeve Publike e të tjera, të cilat duhet të propozojnë përfaqësuesit dhe ekspertët, me të cilët do të përfaqësohen për të kontribuar dhe për të bashkëpunuar me ekspertizën e tyre në grupet e punës për hartimin e analizës dhe më pas të planit të veprimit.



A jeni dakord, apo lista nuk është shteruese? Kuptohet që bashkërisht secili nga kolegët, duke e parë, mund ta plotësojmë, sepse në fund fare është lista e institucioneve që do të jenë të përfshira.

E katërta lidhet me nevojën që, bazuar në pikën 10 të vendimit nr. 50 të Kuvendit për krijimin e këtij komisioni të posaçëm parlamentar t'i kërkojmë Kuvendit, ministres për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ministres së Shtetit për Integrimin Europian, ministrit të Shtetit për Qeverisjen Vendore, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që të mundësojnë që këshilltarë dhe specialistë pranë stafeve të tyre, të përshatshëm për qëllime dhe objektin e punës së këtij komisioni, mund të bëhen pjesë e sekretariatit teknik, i cili do të funksionojë në mbështetje të grupit të ekspertëve pranë komisionit të posaçëm. Dakord.

Vendimmarrja e pestë, që është e natyrës formale, përgatitore, organizative, t'i kërkojmë, në mbështetje të pikës 11, paragrafi 2, të vendimit nr. 50, Kuvendit, ministres së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ministres së Shtetit për Integrimin Europian, që njëkohësisht është edhe kryenegociatorja, ministrit të Shtetit për Qeverisjen Vendore, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që u përfshinë në listat e mëparshme dhe që mund të ketë sugjerime nga kolegët e komisionit edhe në ditët në vijim që të vënë në dispozicion të grupit të ekspertëve dhe të sekretariatit teknik dokumente pune, analiza, strategji plane veprimi dhe të dhëna të ndryshme, që shërbejnë për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së këtij komisioni. Këto kisha.

Mbështetur në vendimin e Kuvendit, gjykova si të arsyeshme se janë hapa të parë të nevojshëm, të domosdoshëm për ta përgatitur procesin nga pikëpamja organizative për hapat e mëtejshëm.

Kolegë, a keni diçka tjetër? Biem dakord me këtë?

Në rregull, nëse nuk kemi gjë tjetër, e mbyllim këtë mbledhje të parë për të përgatitur të gjithë këtë proces dhe për t'u përgatitur për mbledhjen e ardhshme, që besoj se mund të jetë javën e ardhshme, për të cilën do t'ju njoftojmë.

Edhe një herë, faleminderit!

Punë të mbarë, kolegë!

Faleminderit, zonja Kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit stafit të Kuvendit për mbështetjen dhe për bashkëpunimin gjatë këtyre ditëve!

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

**MBYLLET MBLEDHJA**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve  
Euzheni Pengili**

**Koordinator i Komisionit  
Elvi Prifti**